

V E N D I M
Nr.556, datë 10.10.1994

**PËR TARIFAT E SHËRBIMIT QË U KRYHEN PERSONAVE
JURIDIKË E FIZIKË NGA INSPEKTORATI ZJARRFIKËS**

Në zbatim të neneve 14 dhe 15 të ligjit nr. 7707, datë 17.5.1993 "Për mbrojtjen nga zjarri", me propozimin e Ministrisë së Rendit Publik, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Shërbimet dhe tarifavat ndaj personave juridikë e fizikë që kryhen nga Inspektorati MNZ-së të jenë:

a) Miratim projektesh sipas nenit 31 të ligjit nr. 7707, datë 17.5.1993, 500 lekë për vepra me fond deri në 50 milionë lekë dhe 10.000 për veprat mbi 50 milion lekë.

b) Konsulta për probleme të MNZ-së 1.000 lekë.

c) Kualifikimi i punonjësve të ndryshëm për MNZ-në (forca vullnetare) 30 lekë/ora çdo person.

ç) Vënie në dispozicion të automjeteve dhe pajisjeve të teknikës zjarrfikëse, kur kryhen veprimtari që paraqesin rrezik zjarri ose fatkeqësi publike 1 orë 500 lekë.

d) Hapje dyersh e dritaresh të bllokuara 1000 lekë.

dh) Thithje uji 500 lekë/ora.

e) Vendosja në punë e pajisjeve zjarrfikëse (fikësa, motopompa, shkallë etj.) 1000 lekë/ora.

ë) Instruktim për përdorimin e pajisjeve zjarrfikëse 1000 lekë.

f) Transport uji, 1 m³ 100 lekë/km.

g) Dhënie e licencës për prodhimin, tregtimin dhe mirëmbajtjen e pajisjeve zjarrfikëse 4000 lekë.

2. Arkëtimi i parave nga personat juridikë e fizikë bëhet me dokument në numrin e llogarisë së komisarariatit të policisë së rrethit, ku vepron inspektorati i MNZ-së.

3. Të ardhurat që realizohen prej këtyre shërbimeve, 30 për qind i kalojnë buxhetit të shtetit dhe 70 për qind lihen në dispozicion të Ministrisë së Rendit Publik, për t'i përdorur për nevojat e Inspektoratit të MNZ-së.

4. Ministria e Financave dhe Ministria e Rendit Publik ngarkohen të nxjerrin udhëzim për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe i shtrin efektet e tij nga data 1.10.1994.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi